



**AN OIFIG UM CHOSAINT IDIRNÁISIÚNTA
INTERNATIONAL PROTECTION OFFICE**

IPO (SP) 05

SHËNIM INFORMUES

Rregulloret e Bashkimit Evropian (Mbrojtja Plotësuese), 2017

Ky shënim është vetëm për informacion dhe udhëzime. Nuk synon të bëjë një interpretim ligjor të këtyre Rregulloreve

1. PËR ÇFARË JANË KËTO RREGULLORE?

- 1.1 Rregullorja e Bashkimit Evropian (Mbrojtja Plotësuese) 2017¹ (Rregullorja 2017) në lidhje me bërjen e kërkesave për mbrojtje plotësuese nga disa kategori të personave do të hyjë në veprim më 2 Tetor 2017. Këto Rregullore hyjnë në fuqi duke marrë parasysh jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (CJEU) në çështjen C-429/15 E.D. kundër Ministrit për Drejtësi dhe Barazi ECLI:EU:C:2016:789 dhe Gjykata e Apelit për të njëjtën çështje E.D. kundër Ministrit të Drejtësisë dhe Barazisë (Nr.2) [2017] IECA 20.
- 1.2 Shqyrtimi i aplikimeve sipas Rregulloreve 2017 do të ndërmerret nga Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPO).

2. PËR KË ZBATOHEN RREGULLAT E 2017?

- 2.1 Nëse jeni një person të cilit i është refuzuar statusi i refugjatit në Shtet që nga hyrja në fuqi e Rregulloreve 2006 (Rregullorja 2006)², më 10 tetor 2006 nga Komunitetet Evropiane (Pranueshmëria për Mbrojtje) dhe ju jeni ftuar si rrjedhojë për të aplikuar për mbrojtje plotësuese sipas Rregulloreve 2006 ose Rregulloret e Bashkimit Evropian (Mbrojtja Plotësuese), Rregullores 2013 (Rregulloreve 2013)³ dhe:
- a) ju nuk e keni bërë aplikimin sepse keni besuar se nuk keni të drejtë ta bëni këtë në bazë të faktit se afati kohor 15 ditë pune ka kaluar, ose
 - b) keni bërë një kërkesë të vonuar për mbrojtje plotësuese, kërkesa e cila, në bazë të faktit se afati kohor prej 15 ditësh pune kishte skaduar, nuk u shqyrtua apo nuk u mor në konsideratë,

¹ S.I. Nr. 409 nga 2017

² S.I. Nr. 518 nga 2006

³ S.I. Nr. 426 nga 2013

në varësi të dispozitave të Rregulloreve të vitit 2017, ju tani keni të drejtë të zbatoni këto Rregullore për të aplikuar për mbrojtje plotësuese.

3. A DUHET TË PËRMBUSH NDONJË KUSHT PËR TË APLIKUAR SIPAS RREGULLOREVE TË 2017?

3.1 Për të përfituar nga ky proces sipas Rregulloreve të vitit 2017 ju duhet të plotësoni kriteret e mëposhtme:

- i. ju duhet të jeni prezent në Shtet më 2 Tetor 2017.
- ii. ju duhet të aplikoni personalisht në Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare.

3.2 Nëse ju është dhënë statusi i refugjatit ose mbrojtja plotësuese në këtë Shtet ose në një shtet tjetër anëtar të BE-së, ju nuk keni të drejtë të aplikoni në këtë proces.

4. SI MUND TË APLIKOJ PËR MBROJTJE PLOTËSUESE SIPAS RREGULLORES SË 2017 DHE ÇFARË INFORMACIONI DUHET TË JAP?

4.1 Kërkesa për t'u pranuar në procesin e mbrojtjes plotësuese sipas Rregulloreve 2017 duhet të jetë në përputhje me sa më poshtë:

- i. Aplikimi **duhet të bëhet personalisht** pranë Zyrtarit të Mbrojtjes Ndërkombëtare në Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare brenda 30 ditëve të punës nga 2 Tetori 2017 (d.m.th. nga 2 Tetori 2017 deri më datën 13 Nentor 2017).
- ii. Aplikimi duhet të bëhet në **formularin e aplikimit (IPO (SP) 01)** i specifikuar në Shtojcën 1 të Rregulloreve 2017 ose një formë me efekt të ngjashëm.
- iii. Ju gjithashtu duhet të dorëzoni një **deklaratë statutore (IPO (SP) 02)** në formën e specifikuar në Shtojcës 2 të Rregulloreve 2017. Deklarata statutore⁴ e plotësuar duhet ndër të tjera të theksojë
 - bazën mbi të cilën ju keni të drejtë të aplikoni sipas Rregulloreve të vitit 2017,
 - që nuk ju është dhënë statusi i refugjatit ose mbrojtja plotësuese në Shtet ose në ndonjë Shtet tjetër Anëtarë të BE-së dhe
 - se keni qenë të pranishëm në Shtet më 2 Tetor 2017.

4.2 Nëse aplikimi juaj pranohet për shqyrtim në IPO, do të caktohet për intervistë në kohën e duhur. Kur dorëzoni formularin e aplikimit, ju mund të jepni ndonjë informacion shtesë për të mbështetur kërkesën tuaj në përputhje me rregulloret e vitit 2013.

⁴Shënim: Deklarata Statutore duhet të deklarohet para një Noteri Publik, një Komisioner për Betim, një Komisioner i Paqes ose një person i autorizuar nga ligji për të marrë dhe pranuar Deklarata Statutore.

5. KU MUND TË MARR FORMULARIN E APLIKIMIT DHE DOKUMENTE TË TJERA SHOQËRUESE?

- 5.1 Formulari i aplikimit (**IPO (SP) 01**), që shoqëron deklaratën statutores (**IPO (SPO) 02**) dhe informacione të tjera mund të merren duke u paraqitur personalisht në Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare ose duke kontaktuar IPO me telefon. Në rastin e fundit, informacioni do t'ju dërgohet me postë. Kur paraqiteni personalisht në IPO ose nëse kontaktoni IPO me telefon, juve ju kërkohet të jepni informata të caktuara për të verifikuar identitetin tuaj dhe për të konfirmuar se ju është refuzuar statusi i refugjatit në Shtet, që nga hyrja në fuqi e Rregulloreve të vitit 2006.

6. KU DUHET TA KTHEJ FORMULARIN E APLIKIMIT?

- 6.1 Formulari i plotësuar i aplikimit dhe dokumentacioni tjetër shoqëruar **duhet të kthehet personalisht nga 2 Tetori 2017 deri më datën 13 Nentor 2017** në Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare.

- 6.2 Adresa është si më poshtë:

**International Protection Office,
Irish Naturalisation and Immigration Service,
79-83 Lower Mount Street,
Dublin 2. D02 ND99**

Telefon: +353 1 602 8008 (Qendra e Shërbimit të Klientit)

Faks: + 353 1 602 8122

Email: info@ipo.gov.ie

7. ÇFARË DO TË NDODHË NË IPO?

- 7.1 Kur merrni pjesë në IPO me dokumentacionin tuaj të plotësuar për të bërë një kërkesë për mbrojtje plotësuese, në varësi të dispozitave të Rregulloreve të vitit 2017, stafi do të regjistrojë kërkesën tuaj pas disa kontrolleve verifikuese duke përfshirë të drejtën tuaj për të aplikuar dhe një kontroll konfirmimi se ju është refuzuar më parë statusi i refugjatit në Shtet.
- 7.2 Ju lutemi të sillni me vete çdo informacion që mund të keni në lidhje me kërkesën tuaj të mëparshme për statusin e refugjatit (përfshirë datën e aplikimit, datën e vendimit, numrin e referencës etj.).
- 7.3 Si pjesë e procesit të verifikimit ju gjithashtu do t'ju kërkohet të jepni shenjat e gishtërinjve tuaj.

8. KUSH DO TA SHQYRTOJË APLIKIMIN TIM PËR MBROJTJEN PLOTËSUESE?

- 8.1 Me kusht që të përmbushni kushtet për pranimin e saj sipas Rregulloreve të vitit 2017, kërkesa juaj do të shqyrtohet nga një Zyrtar i Mbrojtjes Ndërkombëtare në Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare sipas Rregulloreve 2013 të Bashkimit Evropian (Mbrojtja Plotësuese).

8.2 **IPO-ja do t'ju kontaktojë në kohën e duhur rreth planifikimit për intervistën tuaj të mbrojtjes plotësuese, sapo aplikimi juaj të jetë pranuar, kështu që nuk ka nevojë që ju të kontaktoni IPO-në, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për këtë çështje.**

9. KONSULENCË LIGJORE

9.1 Rekomandohet që të merrni konsulencë ligjore nëse keni të drejtë të aplikoni sipas Rregulloreve të vitit 2017.

10. PYETJE

10.1 Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë proces aplikimi, ju lutemi kontaktoni Zyren e Mbrojtjes Ndërkombëtare - detajet e kontaktit më sipër.

11. INFORMACION MBI MBROJTJEN PLOTËSUESE

11.1 Informacioni mbi mbrojtjen plotësuese është në **Shtojcën e** këtij shënimi informativ.

INFORMACION MBI MBROJTJEN PLOTËSUESE

1. Qëllimi i Rregulloreve 2013.

- 1.1 Rregulloret e Bashkimit Evropian (Mbrojtja Plotësuese) 2013 parashikojnë një sistem për shqyrtimin dhe përcaktimin e kërkesave për mbrojtje plotësuese të bëra në Shtet më ose pas 14 Nëntorit 2013.

2. Çfarë është mbrojtja plotësuese?

- 2.1 Mbrojtja plotësuese është mbrojtje që i jepet një personi për të cilin janë treguar shkaqe thelbësore për të besuar se personi në fjalë, nëse kthehet në vendin e tij ose të saj të origjinës, do të përballë me një rrezik real të vuajtjes së dëmit serioz dhe i cili nuk është në gjendje ose për shkak të një rreziku të tillë nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi dhe i cili nuk përjashtohet nga marrja e të drejtës për mbrojtje plotësuese.

2.2 Dëm serioz do të thotë -

- (a) dënim me vdekje ose ekzekutim; ose
- (b) tortura ose trajtim çnjerëzor ose poshtërues ose ndëshkimi i një personi në vendin e tij ose të saj të origjinës; ose
- (c) kërcënim serioz dhe individual për jetën ose personin e një qytetari për shkak të dhunës pa dallim në një situatë konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm.

- 2.3 Nëse kualifikoheni për mbrojtje plotësuese ju do të lejoheni të qëndroni në Shtet dhe ju do të kualifikoheni për disa të drejta. Këto të drejta janë të përcaktuara në Rregulloret 2013.

3. Kush ka të drejtë për mbrojtje plotësuese?

- 3.1 Me kusht që të jeni në Shtet kur bëni kërkesën tuaj, ju keni të drejtë për mbrojtje plotësuese në pajtim me Rregulloret 2013 nëse:

- (a) ju nuk jeni shtetas i një Shteti Anëtar të Bashkimit Evropian,
- (b) ju është refuzuar një deklaratë si refugjat në Irlandë,
- (c) ka arsye të konsiderueshme për të besuar se nëse ktheheni në vendin tuaj të origjinës, ju do të përballeni me një rrezik real të vuajtjes së një dëmtimi të rëndë dhe nuk jeni në gjendje ose, për shkak të një rreziku të tillë, jo i gatshëm të përfitoni nga mbrojtja e atij vendi dhe
- (d) ju nuk jeni përjashtuar nga të qenit i pranueshëm.

3.2 Ju do të përjashtoheni nga kualifikimi për mbrojtje plotësuese në përputhje me rregulloret e vitit 2013 nëse ka arsye serioze për të konsideruar se ju -

- (a) keni kryer një krim kundër paqes, një krim luftime ose një krim kundër njerëzimit, siç përcaktohet në instrumentet ndërkombëtare të hartuara për të parashikuar krime të tilla;
- (b) keni kryer një krim të rëndë;
- (c) keni qenë fajtor për veprime në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara, siç përcaktohet në Preambulën dhe Nenet 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara ose
- (d) përbëni rrezik për komunitetin ose për sigurinë e Shtetit.

3.3 Ju gjithashtu do të përjashtoheni nga kualifikimi për mbrojtje plotësuese nëse:

- (i) ka arsye serioze për të konsideruar se ju keni nxitur ose keni marrë pjesë në kryerjen e një krimi ose një veprimi të përmendur në paragrafin 3.2 (a) deri (d),
- (ii) ju jeni larguar nga vendi juaj i origjinës vetëm për të shmangur sanksionet që rezultojnë nga një krim apo krime (por që nuk përbëjnë një krim apo sjellje të renditur në paragrafin 3.2 (a) deri (d)) të kryera para hyrjes tuaj në Shtetin ku këto krimet do të dënoheshin me burgim po të ishin kryer në këtë Shtet.

4. Kush mund të aplikojë për mbrojtjen plotësuese në Shtet?

- 4.1 Në varësi të Rregulloreve 2013, një kërkesë për mbrojtje plotësuese mund të bëhet nga një person
- (i) i cili ndodhet në Shtet dhe
 - (ii) i është refuzuar një deklaratë si refugjat në Irlandë.

5. Si do të hetohet kërkesa ime për mbrojtje plotësuese nga Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare?

- 5.1 Kërkesa juaj për mbrojtje plotësuese do të hetohet dhe përcaktohet nga një Zyrtar i Mbrojtjes Ndërkombëtar në pajtim me Rregulloret 2013.
- 5.2 Sipas procedurave për shqyrtimin e aplikimeve për mbrojtje plotësuese, do t'ju kërkohet të merrni pjesë në një intervistë në lidhje me kërkesën tuaj. Qëllimi i intervistës është të përcaktojë detajet e plota të kërkesës suaj për mbrojtje plotësuese.
- 5.3 Një aplikant duhet të marrë pjesë në një intervistë në Zyrën Ndërkombëtare të Mbrojtjes në datën dhe kohën e caktuar për intervistë. Kur një aplikant nuk merr pjesë në intervistën e tij të planifikuar, kërkesa e tij mund të konsiderohet e tërhequr.
- 5.4 Një aplikant mund të bëjë përfaqësim me shkrim (duke përfshirë paraqitjen e dokumentacionit përkatës për të mbështetur një kërkesë) tek Zyrtari i Mbrojtjes Ndërkombëtare në Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare në lidhje me çdo çështje që ka të bëjë me hetimin dhe Zyrtari i Zyrës Ndërkombëtare të Mbrojtjes/Zyra Ndërkombëtare e Mbrojtjes do të marrë parasysh çdo përfaqësim që është bërë para ose gjatë një interviste sipas Rregulloreve 2013. Përfaqësimet mund të bëhen edhe nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët dhe nga çdo person tjetër i interesuar.
- 5.5 Kurdo që është e nevojshme për të siguruar komunikimin e duhur gjatë një interviste, një përkthyes do të sigurohet nga Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare.

6. Skicimi i planifikimit të shqyrtimit

6.1 Më poshtë është një skicë e planifikimit të shqyrtimit për aplikimet për mbrojtje plotësuese.

- (i) Zyrtari i Mbrojtjes Ndërkombëtare/Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare do të planifikojë që të intervistoheni në lidhje me kërkesën tuaj.
- (ii) Pas intervistës, do të përgatitet një raport me shkrim mbi rezultatet e shqyrtimit të kërkesës suaj dhe rekomandimin e bërë nga Zyrtari i Mbrojtjes Ndërkombëtare për Ministrin e Drejtësisë dhe Barazisë nëse ju jeni një person i cili ka të drejtën e mbrojtjes plotësuese.
- (iii) Në rast të një rekomandimi negativ, do të keni të drejtë të apelonit rekomandimin tek Gjykata Ndërkombëtare për Apelimet e Mbrojtjes Ndërkombëtare (“Gjykata”) brenda 15 ditëve të punës nga dërgimi i rekomandimit negativ të Zyrtarit të Mbrojtjes Ndërkombëtare. Gjykata do të mbajë një seancë dëgjimore kur kërkuesi e kërkon këtë në njoftimin e tij të apelit; përndryshe, ankesa mund të përcaktohet pa seancë dëgjimore.
- (iv) Bazuar në rekomandimin e Zyrtarit të Mbrojtjes Ndërkombëtare ose në vendimin e Gjykatës, Ministri, në pajtim me Rregulloret 2013 do t’ju japë ose jo një deklaratë mbrojtëse plotësuese sipas përkatësisë.

6.2 Në rast të refuzimit të kërkesës suaj për mbrojtje plotësuese nga Ministri, do t’ju jepet një njoftim me shkrim ku thuhet se:

- (a) kërkesa juaj për mbrojtje plotësuese është refuzuar;
- (b) periudha e të drejtës tuaj për të qëndruar në Shtet ka skaduar;
- (c) Ministri propozon të bëjë një urdhër deportimi sipas nenit 3 të Aktit të Emigracionit 1999 i cili kërkon që ju të largoheni nga shteti; dhe
- (d) ju keni mundësinë të bëni përfaqësime te Ministri brenda 15 ditëve të punës, duke përcaktuar se pse ju duhet të lejoheni të qëndroni në Shtet.

7. Informacion tjetër

- 7.1 Ju keni të drejtë të konsultoheni me një avokat dhe mund të përfitoni nga shërbimet e Bordit të Ndhmës Juridike (LAB) në lidhje me kërkesën tuaj për mbrojtje plotësuese. LAB është një organ i pavarur i krijuar për të siguruar një shërbim ligjor konfidencial për personat që aplikojnë për mbrojtje në Irlandë. LAB do të ofrojë konsulencë ligjore dhe ndihmë në mbështetje të kërkesës suaj. Nga ana tjetër, mund të kërkonti shërbimet e një avokati privat me shpenzimet tuaja. Ju keni të drejtë të konsultoheni me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët.
- 7.2 Ju keni leje të qëndroni në Shtet derisa të jetë marrë një vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën tuaj për mbrojtje plotësuese. Ministri do t'i sigurojë aplikuesit një letër për këtë qëllim.
- 7.3 Rregulloret e vitit 2013 duhet të konsultohen për çështje të tjera procedurale që nuk trajtohen në këtë Shënim Informativ dhe për detajet e të drejtave të një personi që gëzon të drejtën për mbrojtje plotësuese dhe në lidhje me të cilët është në fuqi një deklaratë mbrojtëse plotësuese.

Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare

22 Shtator 2017

DISA DETAJE KONTAKTI

International Protection Office

Irish Naturalisation and Immigration Service,
79-83 Lower Mount Street,
Dublin 2.
D02 ND99

Telefon: +353 1 602 8000
Faks: + 353 1 602 8122
Email: info@ipo.gov.ie
Faqe në internet: www.ipo.gov.ie

International Protection Appeals Tribunal

6/7 Hanover Street,
Dublin 2.
D02 W320

Telefon: +353 1 474 8400
Numër lokal: 1890 210 458
Faks: +353 1 474 8410
Email: info@protectionappeals.ie
Faqe në internet: www.protectionappeals.ie

Legal Aid Board (Smithfield)

48/49 North Brunswick Street,
Georges Lane,
Dublin 7.
D07 PE0C

Telefon: (01) 646 9600
Faks: (01) 671 0200
Email: lawcentresmithfield@legalaidboard.ie

International Organisation for Migration

116 Lower Baggot Street,
Dublin 2.
D02 R252

Telefon falas: 1800 406 406
Telefon: +353 1 676 0655
Email: iomdublin@iom.int
Faqe në internet: www.ireland.iom.int/

United Nations High Commissioner for Refugees

102 Pembroke Road,
Ballsbridge,
Dublin 4.
D04 E7N6

Telefon: 01 631 4510
Faqe në internet: www.unhcr.org